

LIGJ
Nr. 93/2023

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “AFTËSIA RIPËRTËRITËSE
E PARË DHE ZHVILLIMI I GJELBËR – HUA PËR POLITIKAT E ZHVILLIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër – hua për politikatat e zhvillimit” sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 338, datë 23.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

HUAJA NUMËR 94860-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(AFTËSIA RIPËRTËRITËSE E PARË DHE ZHVILLIMI I GJELBËR,
HUA PËR POLITIKAT E ZHVILLIMIT)
NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshja me datë, sipas Datës së Nënshkrimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), për qëllimin e ofrimit të financimit për mbështetjen e Programit (sipas përcaktimit në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje). Banka ka vendosur të ofrojë këtë financim, ndër të tjera, bazuar në: i. veprimet e ndërmarrja tashmë nga Huamarrësi në kuadër të Programit të cilat janë të përshkruara në seksionin I, të Planit të Punës 1, të kësaj Marrëveshjeje; dhe ii. ruajtjen e një kuadri politikash të përshtatshme makroekonomike nga ana e Huamarrësit. Huamarrësi dhe Banka bien dakord sikurse parashikohet më poshtë:

Neni I

Kushte të përgjithshme; përkufizime

1.01. Kushtet e përgjithshme (sikurse përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02. Me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat me shkronjë të madhe të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u caktohen atyre në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01. Banka pranon t'i japë hua Huamarrësit shumë prej njëqind e dhjetë milionë e tetëqind mijë (EUR 110.800.000) euro, në sasinë që një shumë e tillë mund të këmbëhet herë pas here përmes Kursit të Këmbimit (Huaja).

2.02. Tarifa Paraprake është një e katërta e një përqindëshit (0,25%) të shumës së Huas.

2.03. Tarifa e Angazhimit është një e katërta e një përqindëshit (0,25%) në vit mbi Bilancin e Huas së Patërhequr.

2.04. Norma e interesit është Norma e Referencës plus Përhapja e Ndryshueshme ose një normë që mund të zbatohet pas Këmbimit; i nënshtrohet seksionit 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.05. Datat e Pagesës janë 15 janar dhe 15 korrik të çdo viti.

2.06. Shuma e principalit të huas ripaguhet në përputhje me Planin e Punës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07. Pa kufizuar dispozitat e seksionit 5.05 të Kushteve të Përgjithshme, Huamarrësi i siguron menjëherë Bankës informacionin që lidhet me dispozitat e këtij neni II, sipas kërkesave të herëpashershme dhe të arsyeshme të Bankës.

Neni III

Programi

3.01. Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj Programit dhe zbatimit të tij. Për këtë qëllim dhe në kuadër të seksionit 5.05 të Kushteve të Përgjithshme:

a) Huamarrësi dhe Banka, herë pas here dhe me kërkesë të cilësdo palë, shkëmbejnë pikëpamjet, lidhur me kuadrin e politikave makroekonomike të Huamarrësit dhe progresin e arritur në zbatimin e Programit;

b) përpara shkëmbimit të këtyre pikëpamjeve, Huamarrësi i vë Bankës në dispozicion për shqyrtim dhe komente një raport për progresin e arritur në zbatimin e Programit, i cili përfshin detajet e kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Banka; dhe

c) pa u kufizuar nga pikat "a" dhe "b" të këtij seksioni, Huamarrësi informon menjëherë Bankën lidhur me çdo situatë që mund të ketë ndikim material në zbrapsjen e objektivave të Programit ose çdo veprimi të ndërmarrë në kuadër të Programit, përfshirë të gjitha veprimet e përcaktuara në seksionin 1, të Planit të Punës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV

Masat korrigjuese të Bankës

4.01. Ngjarja Shtesë e Pezullimit është konkretisht e lidhur me rastin kur vërtetohet një situatë që ul ndjeshëm probabilitetin e zbatimit të Programit, ose një pjesë të konsiderueshme të tij.

4.02. Ngjarja Shtesë e Përsheptimit është konkretisht e lidhur me rastin kur ngjarja e përcaktuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje vërtetohet dhe vijon për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pasi Banka ka njoftuar Huamarrësin lidhur me të.

Neni V

Hyrja në fuqi; përfundimi

5.01. Kushti Shtesë i Hyrjes në Fuqi është konkretisht i lidhur me faktin që Banka është e kënaqur me progresin e arritur nga Huamarrësi në zbatimin e Programit dhe me përshtatshmërinë e kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

5.02. Afati për Efektivitetin është data nëntëdhjetë (90) ditë pas Datës së Nënshkrimit.

Neni VI

Përfaqësimi; adresat

6.01. Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i Financave dhe Ekonomisë.

6.02. Për qëllimet e seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë, Shqipëri; dhe

b) adresa elektronike e Huamarrësit është:

Email: sekretariamin@financa.gov.al

6.03. Për qëllimet e seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe

a) adresa elektronike e Bankës është:

Teleks: Faks:

248423(MCI) ose 1-202-477-6391

64145(MCI)

Marrëveshje e arritur në Datën e Nënshkrimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: DELINA IBRAHIMAJ

Titulli: MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Data: 29.8.2023

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: EMANUEL SALINAS

Titulli: MENAXHER I VENDIT

Data: 29.8.2023

PLANI I PUNËS 1
VEPRIMET E PROGRAMIT; DISPONUESHMËRIA E TË ARDHURAVE TË HUAS

Seksioni I. Veprimet në kuadër të Programit

A. Veprimet e Ndërmarrja në Kuadër të Programit. Veprimet e ndërmarrja nga Huamarrësi në kuadër të Programit përfshijnë sa më poshtë:

Shtylla 1. Përforsimi i aftësisë ripërtëritëse të qeverisë dhe familjeve

1. Huamarrësi ka: a) dorëzuar në Parlament draftligjin e tatimeve për rregullimin e një regjimi të ri tatimor për të vetëpunësuarit, siç vërtetohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 693, datë 26 tetor 2022; dhe b) dhënë të drejtën drejtorit të përgjithshëm të DPT-së të kërkojë kontrolle të HNWI-së dhe të mbajë një regjistër të plotë të individëve që kanë të ardhura në Shqipëri, siç vërtetohet nga ndryshimet në Kodin e Procedurave Tatimore miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 83, datë 24 nëntor 2022.

2. Për të zgjeruar deklaratën e risqeve fiskale në buxhet, Huamarrësi ka miratuar udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 35, datë 29 dhjetor 2022, me qëllim vlerësimin e ekspozimit të buxhetit ndaj risqeve të lidhura me fatkeqësitë natyrore dhe gjurmimin e masave zbutëse, siç vërtetohet nga botimi i udhëzimit të lartpërmendur në faqen e internetit të MFE-së.

3. Huamarrësi ka forcuar aftësinë ripërtëritëse klimatike të investimeve publike duke: i. përfshirë vlerësimin mjedisor dhe kriteret e ndikimit klimatik në procesin e përzgjedhjes së projekteve; dhe ii. përfshirë vlerësimin klimatik në përgatitjen e projekteve, siç vërtetohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27 dhjetor 2022.

4. Huamarrësi ka marrë masa për përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit të përfitimeve të aftësisë së kufizuar duke zbatuar metodën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social në mbarë vendin, siç vërtetohet nga urdhri i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 127, datë 21 janar 2022.

Shtylla 2. Krijja e aftësisë ripërtëritëse për burimet e rinovueshme dhe promovimi i eficiencës së energjisë

5. Huamarrësi ka marrë masa për të zgjeruar dhe diversifikuar furnizimin dhe përdorimin e energjisë, duke dorëzuar në Kuvend ndryshime të Ligjit për Energjinë e Rinovueshme që: i. vënë në zbatim ankandet për prodhuesit prioritarë të energjisë, me qëllim kualifikimin e tyre në skema mbështetjeje; dhe ii. përcaktojnë matjen vjetore për vetëprodhuesit; dhe iii. duke deleguar vendimet për licencimin dhe lejet në Këshillin e Ministrave, siç vërtetohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 837, datë 27 dhjetor 2022.

6. Huamarrësi, për të promovuar tregtinë transparente dhe konkurruese të energjisë, ka operacionalizuar Tregun e Organizuar me Shumicë për tregtimin e energjisë ndërmjet furnizuesve dhe shpërndarësve të energjisë, duke: i. futur tregtimin brenda ditës të energjisë ndërmjet furnizuesve të energjisë (prodhuesit dhe importuesit) dhe shpërndarësit, siç dëshmohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 872, datë 27 dhjetor 2022; dhe ii. rishikuar rregullat e tregut, siç dëshmohet nga vendimi i ERE-s nr. 347, datë 27 dhjetor 2022, që mbulon procedurat e kleringut dhe shlyerjes, procedurat e tregtimit, rregullat ALPEX dhe fjalorin.

7. Huamarrësi ka miratuar masat e detyrueshme për uljen e konsumit të energjisë në godinat publike, me qëllim promovimin e efidencës energjetike në sektorin publik, siç vërtetohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 14, datë 5 tetor 2022.

Shtylla 3. Mbrojtja e mjedisit dhe reduktimi i sasisë së karbonit

8. Huamarrësi ka ndaluar përdorimin e qeseve plastike njëpërdorimshe me trashësi më të vogël se 70 mikron, me qëllim reduktimin e ndotjes në mjedis, siç vërtetohet nga ligji nr. 28, datë 17 mars 2022.

9. Huamarrësi, për të ulur shkarkimet GHG, ka vënë në zbatim një sistem monitorimi, raportimi dhe verifikimi për shkarkimet GHG nga instalimet, siç vërtetohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 889, datë 27 dhjetor 2022.

Seksioni II. Disponueshmëria e të ardhurave të Huas

A. Të përgjithshme. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas sipas dispozitave të këtij seksioni dhe udhëzimeve të tjera shtesë, që Banka mund të përcaktojë përmes njoftimeve drejtuar Huamarrësit.

B. Alokimi i shumave të Huas. Huaja alokohet në: a) një kësht të vetëm tërheqjeje, nga i cili Huamarrësi mund të bëjë tërheqjen e të ardhurave të Huas; dhe b) shumat e kërkuara nga Huamarrësi për pagesën e: i. tarifës paraprake; dhe ii. çdo tavan të Normës së Interesit ose prim të Fashës së Normës së Interesit. Alokimi i shumave të Huas për këtë qëllim përcaktohet në tabelën në vijim:

Alokimet	Shuma e Huas Alokuar (shprehur në EUR)
1. Kësti i Vetëm i Tërheqjes	110.523.000
2. Tarifa paraprake	277.000
3. Shuma për t'u paguar sipas seksionit 4.05 (c) të Kushteve të Përgjithshme	0
SHUMA E PËRGJITHSHME	110.800.000

C. Kushtet e lëshimit të kështit të tërheqjes

Nga Kësti i Vetëm i Tërheqjes nuk bëhet asnjë tërheqje nëse Banka nuk është e kënaqur me: a) zbatimin e Programit nga Huamarrësi; dhe b) përshtatshmërinë e kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

D. Depozitimi i shumave të Huas

Brenda tridhjetë (30) ditëve nga tërheqja e Huas nga Llogaria e Huas, Huamarrësi i raporton Bankës: a) shumën e saktë të përfituar në llogarinë e cituar në seksionin 2.03(a) të Kushteve të Përgjithshme; b) detajet e llogarisë në të cilën shuma ekuivalente në lek shqiptare e të Ardhurave të Huas do të hidhet; c) vërtetimin që një shumë ekuivalente është përfshirë në sistemet e menaxhimit të buxhetit të Huamarrësit; dhe d) deklaratën e hyrjeve dhe disbursimeve të llogarisë së cituar në seksionin 2.03(a) të Kushteve të Përgjithshme.

E. Data e mbylljes. Data e Mbylljes është 31 dhjetor 2024.

PLANI I PUNËS 2¹

SKEDULI I RIPAGIMIT TË AMORTIZIMIT TË LIDHUR ME ANGAZHIMIN

Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të kredisë që paguhet në secilën datë të pagesës së principalit (Aksioni me këste).

Niveli i ripagesave të principalit

Data e pagesës së principalit	Ndarja me këste
Në çdo 15 janar dhe 15 korrik Duke filluar nga 15 korriku 2028 deri më 15 korrik 2040	3.85%
Në 15 janar 2041	3.75%

SHTOJÇË

Përkufizime

1. “Lek shqiptar” nënkupton monedhën e Huamarrësit.
2. “ALPEX” është Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.
3. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 14” është vendimi i Këshillit të Ministrave të Huamarrësit me të njëjtin numër datë 5 tetor 2022 dhe botuar në Fletoren Zyrtare të Huamarrësit nr. 138/2022, “Për marrjen e masave të veçanta gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në furnizimin me energji elektrike”.
4. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 693” është vendimi i Këshillit të Ministrave të Huamarrësit me të njëjtin numër, datë 26 tetor 2022.

¹ Planet e Punës 2 dhe 3 do të përcaktohen përfundimisht bazuar në LCW-në e Huamarrësit

5. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 872” është vendimi i Këshillit të Ministrave të Huamarrësit me të njëjtin numër, datë 27 dhjetor 2022, botuar në Fletoren Zyrtare të Huamarrësit nr. 173/2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 519, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike””.

6. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 837” është vendimi i Këshillit të Ministrave të Huamarrësit me të njëjtin numër, datë 27 dhjetor 2022 dhe i publikuar në faqen e Kuvendit në adresën <http://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/5c8522a2-f572-404e-aff9-d0364a9365b3>.

7. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 887” është vendimi i Këshillit të Ministrave të Huamarrësit me të njëjtin numër, datë 27 dhjetor 2022, botuar në Fletoren Zyrtare të Huamarrësit nr. 177/2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”.

8. “Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 889” nënkupton vendimin e Këshillit të Ministrave të Huamarrësit me të njëjtin numër, datë 27 dhjetor 2022 dhe botuar në Fletoren Zyrtare të Huamarrësit nr. 177/2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për monitorimin, raportimin e emetimeve të gazeve serrë dhe informacione të tjera në lidhje me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar””.

9. “ERE” do të thotë Autoriteti Rregullator i Energjisë i Huamarrësit ose pasardhësi i tij ligjor i tij.

10. “Vendimi nr. 347 i ERE-s” nënkupton vendimin e Bordit të ERE-s me të njëjtin numër, datë 27 dhjetor 2022, “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat, përcaktimet, procedurat e tregtimit ALPEX, përfshirë procedurën e kleringut dhe shlyerjes)” dhe të publikuar në faqen e internetit të ERE-s, në:

https://www.ere.gov.al/images/files/2023/01/09/VendimNr347_Dt_27122022Mbi_kerkesen_e_ALPEX_per_miratim_te_rregullave_te_tr_04012023.pdf.

11. “Kushte të Përgjithshme” do të thotë “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e IBRD-së, financimin e politikave të zhvillimit”, datë 14 dhjetor 2018 (rishikuar më 1 gusht 2020, 21 dhjetor 2020, 1 prill 2021 dhe 1 janar 2022).

12. “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” ose “DPT” nënkupton agjencinë e Huamarrësit nën koordinimin e MFE-së, ose pasardhëse të saj.

13. “GSG” nënkupton gazin serrë.

14. “Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 35” nënkupton udhëzimin me të njëjtin numër, datë 29 dhjetor 2022, “Për procedurat standarde të raportimit dhe monitorimit të riskut fiskal nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë e tjera të sektorit publik” i nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të MFE-së dhe e publikuar në faqen e internetit të MFE-së në: <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/Udhezimi-nr.-35-date-29.12.2022-FRS.pdf>.

15. “Tregu i organizuar me shumicë” nënkupton subjektin e Huamarrësit përgjegjës për menaxhimin dhe funksionimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike nëpërmjet platformës elektronike të tregtimit, platformës elektronike të kleringut dhe shlyerjes financiare për tregjet e ditës në vijim dhe brenda ditës, duke përfshirë ankandet brenda ditës dhe të vazhdueshme, tregtimi ndërmjet anëtarëve të Bursës, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e përcaktuara në zbatim të vendimit 872/2022.

16. “Ligji nr. 28” nënkupton ligjin e Huamarrësit, i të njëjtut numër, datë 17.3.2022, i botuar në Fletoren Zyrtare të Huamarrësit nr. 62/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 2011, ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve””.

17. “Ligji nr. 83” nënkupton ligjin e Huamarrësit me të njëjtin numër, datë 24 nëntor 2022 dhe botuar në Fletoren Zyrtare të Huamarrësit nr. 173/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19 maj 2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”.

18. “MFE” nënkupton Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Huamarrësit, ose pasardhësin e saj ligjor të saj.

19. “MHSP” nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Huamarrësit, ose pasardhësin e saj ligjor të saj.

20. “HNWI” do të thotë individë me vlerë të lartë neto.

21. “Urdhër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 127” nënkupton urdhrin e MSHP-së me të njëjtin numër, datë 21 shkurt 2022, “Për zgjerimin e skemës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar bio-psiko-sociale në të gjitha qarqet e vendit” dhe publikuar në faqen e MSHP-së,

në adresën: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Urdher-nr.-127-Shtrirja-Reformes-1.pdf>.

22. “Program” do të thotë: programi i objektivave, politikave dhe veprimeve të përcaktuara ose të referuara në letrën e datës 16 shkurt 2023, nga Huamarrësi drejtuar Bankës, që deklaron angazhimin e Huamarrësit për ekzekutimin e Programit dhe kërkon ndihmë nga Banka në mbështetje të Programit gjatë ekzekutimit të tij dhe që përfshin veprimet e ndërmarra, duke përfshirë ato të përcaktuara në seksionin I, të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje, dhe veprimet që duhen ndërmarrë në përputhje me objektivat e programit.

23. “Ligji për Energjinë e Rinovueshme” nënkupton projektligjin e Huamarrësit “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” i paraqitur në Parlamentin e Huamarrësit në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 837, të Huamarrësit.

24. “Data e Nënshkrimit” do të thotë data e mëvonshme nga dy datat në të cilat Huamarrësi dhe Banka nënshkruan këtë Marrëveshje dhe një përkufizim i tillë zbatohet për të gjitha referencat për “datën e Marrëveshjes së Huas” në Kushtet e Përgjithshme.

25. “Transh i vetëm tërheqjeje” do të thotë shuma e huas e akorduar në kategorinë e titulluar “Transh i vetëm tërheqjeje”, në tabelën e përcaktuar në pjesën B, të seksionit II, të tabelës 1, të kësaj Marrëveshjeje.